

Ndihmojnë fermerët e Mitrovicës

Mitrovicë, 25 qershor - Zyrtarë të BE-së, të komunave të rajonit të Mitrovicës si dhe ata të IADK-së kanë inspektuar të shtunën financimet e tyre të përbashkëta në agrikulturë në rajonin e Mitrovicës. Financimet e përbashkëta

të këtyre organizmave prej 447 mijë euro, janë bërë në kuadër të projektit "Promovimi i bujqësisë, hortikulturës, blegtorisë dhe prodhimtarisë së frutave" ndërsa janë implementuar nga IADK-ja dhe EURED.

Nuk mund të dënohet

Prishtinë, 25 qershor - Pasi një diplomat nga Zvicra kishte vjedhur një pako "Vitamine" nga një studio për trajnim, nga Zvicra është lajmëruar se ai nuk mund të dënohet, ngase ka një imunitet diplomatësh. Sipas ligjit, Diplomatët nuk mund të dënohen dhe se imuniteti i tyre mbron nga Gjykata. Këtë të drejtë kanë pothuajse të gjithë diplomatët nga e tërë bota. Mirëpo

në disa raste vet Zvicra kishte thyer këtë imunitet, ndërsa tani bën përpjekje për të aktivizuar imunitetin ndaj këtij personi Zviceran. Rasti i fundit ku Zvicra ka thyer ishte dënimi i Ambasadorit të Maqedonisë për shkak të ngasjes së veturës i dehur. Në vitin 2009 Zvicra kishte dënuar një diplomat nga India ngase ai kishte marrë një shërbëtor të cilin e kishte përdorur si një skllav.

SHERINJTE



Vdes Dr. Talat Pallaska

Prishtinë, 25 qershor - Prof. Dr. Talat Pallaska ka vdekur sot, në moshën 81-vjeçare. Dr. Pallaska në vitet 1972-73 ishte drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Prishtinë, ndërsa për meritë të veçanta dekorohet me titullin Primarius. Në vitin 1972 u zgjodh mësimdhënës i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë. Pas një vargu publikimesh shkencore dhe pune të palodhshme, në vitin 1983 avancohet në titullin e profesorit ordinar. Dr. Pallaska kreu edhe shumë detyra udhëheqëse. Në vitet akademike 1972-1974 ishte prodekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, ndërsa në vitet 1979-1981 ishte dekan i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës. Në vitin 1991, Pallaska largohet



dhunshëm nga puna, ndërsa më vonë pensionohet si mjek dhe profesor i Fakultetit të Mjekësisë. Mbledhja komemorative mbahet më 26 qershor (të dielën) në orën 11:00 në Amfiteatrin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, raporton TV21. Kor-tezhi nisët nga shtëpia e të ndjerit në Taslixhe I, nr. 8 në orën 14, kurse varrimi i të ndjerit bëhet më 26 qershor në varrezat e qytetit të Gjakovës, në orën 17.

Po rritet...

Prishtinë, 25 qershor - Kosova, sipas autoriteteve të rendit, vlerësohet si vend transit prej ku shpërndahet droga, por edhe përdorimi i saj. Udhëheqës të organizatave që merren me rehabilitimin e personave të

markotike. Sabrije Kamberi, zëdhënese në Policinë e Kosovës thotë se, në bazë të analizave të bëra nga të arrestuarit për drogë, del se Kosova është vend transit prej ku shpërndahet droga. Sipas zëdhënës Kamberi, substancat